



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/130

Datë: 16.06.2010

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4 dhe nenit 93, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-87 për Ndërmarrjet Publike, dhe paragrafit (3) të nenit 4 Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 01/2007 si dhe bazuar në rekomandimet Komisionit Ndërministror të themeluar me qëllim të analizimit të opsioneve për participimin e sektorit privat në PTK, Qeveria e Republikës së Kosovës, në cilësinë e ushtruesit të ligjshëm të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjen Publike "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës Sh. A. ("PTK"), në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Të ofrohen për tenderim dhe shitje 75 % (shtatëdhjetepesë përqindë) e aksioneve të Ndërmarrjes Publike PTK, Sh. A.
2. Të themelohet Komisioni Qeveritar për Privatizimin e PTK-së në këtë përbërje:
  - Z. Ahmet Shala, Ministër për Ekonomi dhe Financa, Kryesues;
  - Z. Lutfi Zharku, Ministër i Tregtisë dhe Industrisë, anëtar;
  - Z. Fatmir Limaj, Ministër i Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit, anëtar;
  - Z. Nenad Rashiq, Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, anëtar;
  - Z. Sadri Ferati, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal, anëtar.
3. Komisioni Qeveritar për Privatizim të ndjekë një procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese, në përputhje me kushtet procedurale të parapara me ligjet e Republikës së Kosovës dhe me standardet më të larta ndërkombëtare.
4. Komisioni Qeveritar për Privatizim të adresoj dhe negocioj në mënyrë të përgjegjshme-sociale kërkesat e arsyeshme të punëtorëve të PTK Sh. A.
5. Komisioni Qeveritar për Privatizim autorizohet të vendosë për detajet e ndarjes së aseteve të postës nga njësitë tjera të biznesit, duke marrë parasysh si duhet:
  - Interesin e Shtetit të Kosovës për të pasur një subjekt postar funksional dhe
  - Maksimumin e çmimit të shitjes së PTK Sh. A.

6. Të sigurohet që njësia e biznesit posta e PTK Sh. A., të shërbej si ofruar universal i shërbimeve postare edhe gjatë procesit të ndarjes ligjore të njësisë së biznesit Posta, e cila ndarje do të bazohet në marrëveshjen paraprake për alokim të aseteve, me apo pa obligimin që të kthehet në pronësinë e Republikës së Kosovës, të vazhdoj.
7. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që këtë vendimin t'ia procedojë për aprovim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
8. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/130  
Datë: 16.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet me ndryshime Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr. 03/L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Zyra për Shërbimet e Ndihmës Juridike për përfshirjen e vërejtjeve në tekstin e projektligjit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/130

Datë: 16.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor, dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës së Prishtinës, shpallet Zonë e Veçantë ngastrat kadastrale 3114 - 1 deri 3125 - 2, me sipërfaqe të tërësishme prej 90736 m<sup>2</sup> te vendi i quajtur "Lama e Druve", dhe e cila është në pronësi të IMN Kosova.
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin t'ia procedojë për miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 04/130

Datë: 16.06.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, paragrafit 5. të nenit 8 të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme dhe paragrafit (3) të nenit 4 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 qershor 2010, mori

**V E N D I M**

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik, të pronave të paluajtshme, konkretisht parcelave nr. 257, 259, 260, 261 dhe 382 nën administrimin e AKP-së, të cilat ndodhen në zonën kadastrale të Hajvalisë dhe preken nga ndërtimi i Kampusit të Universitetit Amerikan në Kosovë.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministria për Ekonomi për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAJI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë